



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Kryetari i Komunës
Predsjednik Opštine

Komisioni për realizimin e Panairit të VI-të Dimëror
Nr./Br. 01-633/25-7986/5



Shpallur me 12.11.2025 god.
Rruga Tuz nr. 1, nr. 44
Ulica Tuzi br.1, br. 44

+382 20 875 167
kryetari@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 12.11.2025. godine

Komisioni për organizimin e Panairit të VI-të Dimëror (në tekstin e mëtejme: Komisioni), i themeluar me Vendimin e kryetarit, Nr. 01-633/25-7986/1 të datës 5 nëntor 2025, shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM PA KOMPENSIM TË OBJEKTEVE MONTUESE TË KARAKTERIT TË PÛRKOHSHËM (SHTËPIZAVE) PËR NEVOJAT E ORGANIZIMIT TË PAZARIT TË DIMRIT, PËR VITIN 2025

1. Ftohen sipërmarrësit dhe shoqëritë afariste (në tekstin e mëtejme: subjektet afariste) që merren me aktivitete të hotelerisë dhe tregtare, me seli në territorin e komunës së Tuzit, të paraqesin aplikimet për këtë Thirrje Publike.
2. Objektet e përkohshme të karakterit montues (shtëpiza) ofrohen në përdorim për sipërmarrësit dhe shoqëritë afariste për qëllime të organizimit të Pazarit të Dimrit 2025, në përputhje me aktivitetet që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në dokumentet strategjike, programet dhe planet e komunës së Tuzit (fushat prioritare), dhe të cilat në veçanti: inkurajojnë zhvillimin ekonomik të komunës së Tuzit; inkurajojnë zhvillimin e turizmit, kontribuojnë në afirmimin dhe valorizimin e potencialit kulturor, traditës dhe veçantisë kulturore të komunës së Tuzit.
3. Komuna e Tuzit ofron për përdorim 9 objekte montuese të karakterit të përkohshëm (shtëpiza) në Sheshin “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu” nga 20 dhjetori 2025 deri më 2 janar 2026.
4. Aplikimet për thirrjen publike mund të dorëzohen brenda 15 ditëve nga data e publikimit të thirrjes publike, në një zarf të shënuar: i dorëzohet: Komisionit për zbatimin e thirrjes publike për përdorimin pa kompensim të objekteve montuese të karakterit të përkohshëm (shtëpizave) për nevojat e organizimit dhe realizimit të Pazarit të Dimrit 2025., (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

a) Sipërmarrësi paraqet:

- formularin e aplikimit (formulari);
- kopjen e Letërnjoftimit të pronarit të aktivitetit afarist;
- vendimin e regjistrimit nga CRPS (RQSA (certifikata e kryerjes së veprimtarisë ekonomike) jo më të vjetër se tre muaj;
- vendimin e regjistrimit në TVSH nëse përdoruesi është pagues i TVSH-së;
- konfirmimin nga organi i qeverisjes lokale i komunës së Tuzit mbi pagesën e rregullt të detyrimeve për tatimet dhe të ardhurat e tjera lokale, jo më të vjetër se 30 ditë;
- referenca të veçanta dhe çmime (nëse ka);
- provën se ka kryer fiskalizimin në përputhje me Ligjin për Fiskalizim në Shitjen e Produkteve dhe Shërbimeve (Administrata Tatimore e Malit të Zi) - faturë fiskale;

- konfirmimin/faturën se blen produkte nga prodhues vendas të regjistruar (verë, birrë, pije alkoolike, djathë, mish dhe produkte mishi);
- konfirmimin e pjesëmarrjes në të njëjtat organizata ose të ngjashme.

b) Shoqëria Afariste dorëzon:

- aplikim (formular);
- vendim regjistrimi nga CRPS (RQSA) (certifikatë jo më të vjetër se tre muaj);
- vendim regjistrimi për TVSH nëse përdoruesi është pagues i TVSH-së;
- konfirmimin nga organi i qeverisjes lokale i komunës së Tuzit mbi pagesën e rregullt të detyrimeve për tatimet dhe të ardhurat e tjera lokale, jo më të vjetër se 30 ditë;
- certifikatë ose njohje për kontribut në zhvillimin e turizmit dhe hoteljeri (nëse kanë);
- konfirmim i kategorizimit të objektit hoteljer;
- provë se procedura e fiskalizimit është kryer në përputhje me Ligjin për Fiskalizimin në Shitjen e Produkteve dhe Shërbimeve (Administrata Tatimore e Malit të Zi) faturë fiskale;
- konfirmim/faturë se blenë produkte nga prodhues vendas të regjistruar (verë, birrë, pije alkoolike, djathë, mish dhe produkte mishi);
- konfirmim i pjesëmarrjes në të njëjtat organizata ose të ngjashme.

Sipas detyrës zyrtare, Komisioni, siguron Vërtetim mbi mos-dënim për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pronës.

Aktivitetet që nuk do të mbështetën:

- aktivitetet që janë nën përgjegjësinë ose nën kompetencën e Qeverisë së Malit të Zi, siç janë: arsimi formal, kujdesi shëndetësor formal dhe sigurimi social, aktivitete që konsiderohen të paligjshme ose të dëmshme për mjedisin dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut: lojërat e fatit, duhani,
- aktivitete të paligjshme dhe aktivitete për të cilat shoqëria afariste ose sipërmarrësi nuk është i regjistruar.

5. Fushat prioritare për ndarjen e shtëpizave për Pazarin e Dimrit 2025:

1. Prodhimi i ushqimit dhe pijeve,
2. Tregtia e ushqimit dhe pijeve vendase,
3. Shërbime hoteliere (shërbimi i ushqimit dhe pijeve) dhe
4. Prodhimi artizanal dhe sipërmarrja krijuese artizanale.

Komisioni lëshon një Listë mbi përmbushjen e kushteve të aplikantëve, duke u bazuar në notimin e paraqitjeve, në bazë të kritereve më poshtë:

- lidhshmëria e aplikimit me fushat prioritare, deri në 70 pikë;
- programi krijues organizuar nga pjesëmarrësi, deri në 50 pikë

- konfirmim i kategorizimit të objektit hoteljer , deri në 50 pikë;
- subjektet afariste ose sipërmarrësit që punësojnë një person gjatë periudhës së pazarit 50 pikë;
- subjekte afariste ose sipërmarrës që blejnë produkte nga prodhues të regjistruar vendas (verë, birra, pije alkoolike, djathë, mish dhe produkte mishi) 30 pikë;
- çmime kombëtare ose ndërkombëtare deri në 20 pikë;
- posedimi i një certificate ose njohjeje për kontribut në zhvillimin e turizmit dhe hotelierisë 20 pikë;
- konfirmim i pjesëmarrjes në të njëjtat organizime ose të ngjashme 20 pikë.

Aplikantët që nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë kanë të drejtë të paraqesin dokumentacionin që mungon brenda tre (3) ditëve nga data e hapjes së aplikimeve, në të njëjtën mënyrë siç kanë paraqitur aplikimin fillestar. Nëse dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet brenda afatit të caktuar, aplikimi nuk merret më në shqyrtim.

Bazuar në Listën përfundimtare të Renditjes të publikuar në faqen e internetit të Komunës së Tuzit, Kryetari i Komunës merr Vendim për përzgjedhjen dhe lidh kontratë me pjesëmarrësit e përzgjedhur. Zbatimi i kontratës së lidhur do të monitorohet nga Komisioni.

6. Aplikimi për këtë thirrje publike dorëzohet në formularin e përcaktuar, me dokumentacionin e nevojshëm në një zarf të mbyllur, me shënimin: Aplikim në Thirrjen Publike për dhënie në shfrytëzim pa kompensim të objekteve montuese të karakterit të përkohshëm (shtëpizave) për nevojat e organizimit të Pazarit të Dimrit 2025. Dorëzohet në Arkivin e Komunës së Tuzit, Rruga I, nr. 44 Tuz, ditëve të punës nga ora 09.00 deri në orën 15.00, nga **12 nëntori deri më 27 nëntor 2025**.

7. **Dokumentacioni i dorëzuar jashtë afatit të paraparë, nuk do të shqyrtohet nga Komisioni.** Informacione mbi të gjitha çështjet që lidhen me pjesëmarrjen në Thirrjen Publike mund të merret çdo ditë pune në telefon: 020/875-167 ose në email: tuzi@tuzi.org.me

Kjo Thirrje Publike do të publikohet në faqen e internetit të komunës së Tuzit **www.tuzi.org** dhe në një media lokale.

KRYETARE E KOMISIONIT

Marina Ujkaj

